



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 21.03.2025
Numër Protokoll: 1894/2025

A.nr.186/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.186/2025, të datës 23.01.2025, të parashtruar nga ankuesja R.D, kundër organit: Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.03.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa A.nr.186/2025, e datës 23.01.2025, e parashtruar nga ankuesja R.D.
- II. Mbetet në fuqi** Njoftimi i vlerësimit përfundimtar të kandidatëve të suksesshëm i datës 27.12.2024 i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, R.D (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), me datë 23.01.2025, përmes emailit zyrtar ankesa.kpmshck@rks-org.net, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjën A.nr.186/2025, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, për shpalljen e rezultateve përfundimtare lidhur me konkursin me numër Reference: RN00015585, për grupin e administrimit të përgjithshëm për pozitën Zyrtar i Skemave Pensionale, i shpallur nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 28.01.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (tutje MFPT), ndërsa kjo e fundit, me datë 06.02.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokollit 487/2025 e parashtruar nga ankuesja më datën 23.01.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankueses; Konkursin e datës 23.10.2025; Njoftimin e datës 27.12.2024; E-mailin e datës 22.01.2025 dërguar nga ankuesja në Këshill me korrespondencën e bashkangjitur; Formular i regjistrimit të ankesës; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.01.2025; Përgjigja në kërkesë e datës 06.02.2025; Vendimin me numër protokollit 3466/2024 të datës 17.12.2024 për themelimin e Komisionit të Pranimit dhe Akt Emërimet e anëtarëve të komisionit të pranimit; Njoftimin për kandidatin fitues i datës 27.12.2024; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 20.12.2024; Formularët e vlerësimit individual të anëtarëve të komisionit për kandidatin në intervistë; Testet-ese me shkrim; Aplikacioni i ankueses i datës 29.10.2024 me dokumentacionin e bashkangjitur me rastin e aplikimit; Aplikacioni i kandidatës B.B-T i datës 20.11.2024 me dokumentet e bashkangjitura me rastin e aplikimit;

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se MFPT, më datë 23.10.2024 ka shpallur konkursin me numër reference RN00015585, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita *Zyrtar i Skemave Pensionale- Profesional 2*, në Departamentin e Pensioneve, ku afati për aplikim ka qenë nga data 24.10.2024 deri më 22.11.2024, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në këtë konkurs kanë aplikuar 71 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja, dhe sipas njoftimit të datës 20.12.2024 për verifikim paraprak janë përfshirë 47 kandidatë që i kanë plotësuar kushtet e konkursit në mesin e tyre edhe ankuesja.

Pas përfundimit të fazave të vlerësimit, Divizioni i Burimeve Njerëzore i MFPT-së, më datë 27.12.2024, ka publikuar njoftimin për vlerësimin e rezultateve përfundimtare të kandidatëve fitues, ashtu që kandidatja me më së shumti pikë rezulton të jetë B.B-T me gjithsejtë 87.2 pikë, ndërsa ankuesja rezulton të ketë marrë gjithsejtë 74.2 pikë.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, për shpalljen e kandidatit fitues, pretendon se Komisioni i Pranimit nuk ka qenë profesional dhe se vlerësimi i intervistës me gojë nuk ka qenë objektiv pasi që kundër kandidaten e kanë vlerësuar pothuajse me pikë maksimale, përkundër që kam pasur pikë me shumë në testin me shkrim.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ka analizuar ligjshmërinë e procedurës së pranimit me Nr. reference RN00015585, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita Zyrtar i Skemave Pensionale, në Departamentin e Pensioneve të shpallur nga MFPT, ka konstatuar së për këtë pozitë të punës si kërkesa të përgjithshme formale janë përcaktuar: **Arsimimi i kërkuar:** *Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor).* **Përvoja e punës e kërkuar:** *Së paku një (1) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore dhe shqyrtimit të procedurës së pranimit , Kolegji iu referuar dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht: **Nenit 39:** *1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj. 2. Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni. 5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi” dhe nenit 40 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: “1. Vlerësimi profesional i kandidateve/ëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/e civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/e nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/e i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale.*

Kolegji i Këshillit, duke vepruar sipas pretendimeve të palës ankuesi lidhur me kontestimin e Komisionit të Pranimit, ka shqyrtuar edhe përbërjen e Komisionit të Pranimit dhe nga analizimi i Vendimit me numër protokollit 3462/2024 të datës 17.12.2024 të nxjerr nga u.d Sekretari i Përgjithshëm i MFPT-së, është themeluar Komisioni i Pranimit për vlerësimin profesional të kandidateve në procedurën e pranimit për pozitën Zyrtar i Skemave Pensionale, në përbërje: 1.B.H

-Kryesues, 2. K.O-anëtar, 3. V.Gj.-anëtar, 4. L.Sh-anëtare, dhe 5. R.M, ndërsa sipas akt emërimit e anëtarëve të Komisionit të Pranimit, rezulton se Kryesuesi i Komisionit të pranimit, B.H mban pozitën Drejtor i Departamentit të Pensioneve, anëtari K.O mban pozitën Udhëheqës i Divizionit për Monitorimin e Kontratave të partneritetit Publiko Privat, anëtari V.Gj mban pozitën Udhëheqës i Divizionit për Vlerësimin e Ndihmës Shtetërore, anëtarja L.Sh mban pozitën Zyrtare e Lartë për Çështje Ligjor për PPP, dhe anëtarja R.M mban pozitën Zyrtare e Lartë e Personelit, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se përbërja e Komisionit të Pranimit është në pajtueshmëri me dispozitat e përcaktuara si në nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 20 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se; “Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtare/ë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunëse/ës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësuese/ës nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunëse/ës i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale” si dhe poashtu pati parasysh edhe faktin se aktemrimet që ju kanë lëshuar zyrtarëve që janë pjesë të komisionit të pranimit janë mbi bazën e nenit 102 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë , që nënkupton se të njëjtit kanë qenë në këto pozita para se të hy në fuqi ligji aktual i zyrtarëve publik.

Kolegji i Këshillit, ka shqyrtuar aktin final të procedurës se rekrutimit, respektivisht Njoftimin e datës 27.12.2024, të Divizionit të Burimeve Njerëzore të MFPT-së, për shpalljen e kandidatit fitues, i cili është edhe akti i kontestuar nga pala ankuese, gjegjësisht ka shqyrtuar dosjen e kandidates fituese, nga u konstatua se e njëjta posedon Diplomën e datës 22.02.2022 me numër:1565 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” përmes së cilës dëshmohet se me datë 19.01.2022 ka mbaruar studimet themelore/Bachelor në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë, ndërsa lidhur me përvojën e punës e njëjta posedon kontratën e punës së datës 01.01.2022 të lëshuar nga Pro Consultin and Tradin Sh.P.K si dhe Vërtetimin e datës 01.10.2024, përmes së cilave akte dëshmohet fakti se e njëjta nga data 01.01.2022 e deri me datë 31.12.2023 ka mbajtur pozitën Koordinatorë për mbikëqyrjen e cilësisë dhe standardeve në menaxhim në të njëjtën kompani, sikurse të njëjtën përvojë të punës e mbështet edhe me pasqyrën e llogarisë të lëshuar nga Trusti/Fondi i Kursimeve Pensionale, prandaj me rastin e përfshirjes së kësaj kandidateje në listën e verifikimit paraprak dhe listën e kandidatëve fitues organi përkatës i punësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7, nenit 39 paragrafi 7 nën paragrafi 7.1 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, pasi që e njëjta i ka plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit të datës 23.10.2024.

Lidhur me pretendimin ankimor të ankuses, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e aplikuara të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, nenin 10 paragrafi 4, 6, 9, 10 dhe 11 dhe ku përcaktohet se: “4. Në intervistë, vlerësohen njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara që nuk mund të vlerësohen nëpërmjet testimit me shkrim 6. Intervista në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, përmban pesë (5) pyetje, ku secila vlerësohet me më së shumti katër (4) pikë. Përveç pyetjeve, anëtarët e Komisionit të Pranimit mund të parashetrojnë

*edhe nënpyetje për kandidatin me qëllim të vlerësimit më të saktë të kandidatit lidhur me pyetjen kryesore; 9. Në intervistë kandidati mund të merr më së shumti tridhjetë (30) pikë, ku prej tyre dhjetë (10) pikë janë për jetëshkrimin (CV); 10. Vlerësimi maksimal për jetëshkrimin ndahet si vijon: 10.1. deri në tre (3) pikë për arsimimin; 10.2. deri në katër (4) pikë për përvojën relevante në punë; dhe 10.3. deri në tre (3) pikë për trajnimet relevante. 11. **Vlerësimi përfundimtar i intervistës për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve.**”, ndërsa nga provat e lëndës u konstatua fakti se ankuesja në vlerësimin e përgjithshëm të intervistës ka arritur të grumbulloi gjithsejtë 11.6 pikë, nga mesatarja e vlerësimit të të gjithë anëtarëve të komisionit, ndërsa Kolegji i Këshillit thekson faktin se lidhur me këtë pretendim ankimor, jo detyrimisht anëtarët e komisionit duhet t’i vlerësojnë me maksimalisht pikë kandidatët, përjashtimisht në rastet kur te njëjtë vlerësojnë se përgjigjet e kandidatëve janë brenda pritjeve të dhëna të përgjigjeve të sakta, kurse ankuesja në rrethanat e rastit konkret nuk ka mundur ta mbështes një pretendim të tillë me asnjë provë faktike se pse e njëjta është dashur të vlerësohet më shumë pikë në intervistën me gojë, dhe për rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se ligji material apo rregullorja përkatëse ia ka njohur komisionit të pranimit këtë përgjegjësi apo autorizimin lidhur me vlerësimin e përgjigjeve të dhëna në pyetjet përkatëse, ndërsa i ka rregulluar çështjet e tjera procedurale sipas përcaktimeve të dispozitave të lartcekura.*

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit duke marrë përbazë dispozitat e aplikuara të ligjit material, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, dhe pas konstatimit se pretendimet ankimore të ankueses nuk janë të bazuara, vendosi që ankesën e saj ta refuzoi sikurse në dispozitiv e këtij vendimi, ndërsa ka lënë në fuqi Njoftimin e datës 27.12.2024 të renditjes përfundimtare të kandidatëve, të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MFPT-së, pasi që konkursi i shpallur me datë 23.10.2024 dhe numër reference RN00015585 për pozitën “Zyrtar i Skemave Pensionale” Profesional 2- Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 7 paragrafi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1. Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil, nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese, dhe se kolegji nuk u lëshue në çështje tjera që mund të ndërlihen me këtë procedurë të pranimit ngase nuk do të kishte ndikim sa i përket vendimmarrjes si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.186/2025, datë 21/03/2025.

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses R.D;
- Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.